

Akt Themelimi & Statut  
i  
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
\*\*\*

UNIVERSITETI DITA  
SH.P.K

02.09.2016

PËRMBAJTJA

## PËRMBAJTJA

### THEMELIMI

#### KAPITULLI I - Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1 – Emri i Shoqërisë

Neni 2 – Forma Ligjore

Neni 3 – Selia e Shoqërisë

Neni 4 – Kohëzgjatja

#### KAPITULLI II - Objekti

Neni 5 – Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë

Neni 6 – Ndryshimi i Objektit

KAPITULLI III - Kapitali Themeltar dhe Kuotat, Zmadbimi dbe Zvogëlimi i Kapitalit, Ortakët, Largimi dbe Përjashtimi i Ortakëve

Neni 7 – Kapitali Themeltar die Kuotat

Neni 8 – Zvogëlimi ose Zmadbimi i Kapitalit Themeltar

Neni 9 – Ortakët

Neni 10 – Largimi i Ortakëve

Neni 11 – Përjashtimi i Ortakëve

#### KAPITULLI IV - Bashkëzotërimi, Transferimi, Anullimi dbe Likuidimi i Kuotave, Vënia në vonesë

Neni 12 – Bashkëzotërimi i Kuotave

Neni 13 – Transferimi i Kuotave

Neni 14 – Anullimi dbe Likuidimi i Kuotave

Neni 15 – Vënia në Vonesë

#### KAPITULLI V - Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve

Neni 16 – Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve

Neni 17 – Thirrja e Asamblesë së Pergjithshme të Ortakëve

Neni 18 – Punimet e Asamblesë së Pergjithshme të Ortakëve

Neni 19 – Kuorioni dbe Vendim-Marija

#### KAPITULLI VI - Administratori

Neni 20 – Emërimi, Kohëzgjatja e Mandatit dbe Shkarkimi i Administratorit

Neni 21 – Të Drejtat dbe Detyrimet e Administratorit

Neni 22 – Shtypërlimi dbe Tagrat e Përfaqësimit

#### KAPITULLI VII - Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 23 – Eksperti Kontabël i Autorizuar

Neni 24 – Viti Financiar

Neni 25 – Mbajtja e Llogarive

Neni 26 – Llogaritura dbe Shpérndarja e Fitimit

#### KAPITULLI VIII - Ndryshimi i Formës Ligjore, Prishja, Likuidimi

Neni 27 – Ndryshimi i Formës Ligjore

Neni 28 – Prishja e Shoqërisë

Neni 29 – Likuidimi

#### KAPITULLI IX - Të ndryshme

Neni 30 – Njoftimet

Neni 31 – Ligji i Zbatueshmë dbe Gjykata Kompetente

## THEMELIMI

Sot në datën 02.09.2016, në Tiranë, Shqipëri u mblohdën palët e mëposhtëme, të cilët janë Ortakët Themelues të shoqërisë “ Universiteti Dita” Sh.p.k (referuar më poshtë si “Ortakët Themelues”):

- *Alban Dabulla, lindur më 22.02.1977 në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madbor dbe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 027878575*
- *Shyqyri Dade, , lindur më 14.11.1959 në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madbor dbe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 029247181;*
- *Adrian Tbano, lindur më 13.03.1975 në Fier, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madbor dbe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 028819733;*
- *Leart Kola, lindur më 09.09.1983 në Durrës, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madbor dbe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 029190827.*

Ortakët Themelues, sot në datën 02.09.2016 (“Data e Themelimit”), deklarojnë vullnetin, e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Universiteti Dita” Sh.p.k (referuar më poshtë si “Shoqëria” ose “Universiteti Dita” Sh.p.k), një person juridik shqiptar themeluar në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe me termat dhe kushtet e vendosura në këtë Akt Themelimi dhe Statut të Shoqërisë. Ortakët Themelues nënshkruajnë Aktin e Themelimit dhe Statutin.

\*\*\*\*\*

### KAPITULLI I Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

#### Neni 1

##### Emri i Shoqërise

1. Emri i Shoqërisë është “UNIVERSITETI DITA”, ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “shpk”, i cili përfaqëson formën ligjore të saj.
2. Emri Tregtar i Shoqërisë është “Universiteti Dita”.

#### Neni 2

##### Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### Neni 3

##### Selia e Shoqërisë

- 3.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Diga e Ligenit, Vila ne zonen kadastrale 8270, Nr. pasurie 8/193, Kati 2, Njesia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjeter të Shqipërisë.
- 3.3. Shoqëria mund të hap, filiale, degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

- 4.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

## KAPITULLI II

### Objekti

#### Neni 5

##### Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

- 5.1. Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
- Aktivitet ne fushen e Arsimit privat te larte Universitar dhe pasuniversitar,kolegje e kurse afatshkurter,afatmesem e afatgjate para dhe pasuniversitar;
  - Administrimi dhe drejtimi didaktik i institucionit arsimor te larte,jo publik,universitar dhe pasuniversitar si dhe aktivitete te tjera ndihmese per kete lloj veprimtarie.Kryerja e kualifikimeve shkencore pasuniversitare,kurseve te specializimit dhe kurseve te kualifikimit afatshkurter dhe afatgjate.
- 5.2. Në përputhje me legjisacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpermendur, Shoqëria mund:
  - të kryejë çdo lloj aktiviteti në raport me objektin dhe për ta favorizuar atë;
  - të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qera, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
  - të kryeje aktivitetë publikimi dhe reklamimi për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
  - të veprojë si konsulent, në cfareolloj fushe të aktivitetit tregtar, dhe në përgjithësi të angazhohet në projekte kërkimesh dhe projekte zhvillimi aktivitetesh në të gjitha fushat me interes tregtar dhe shoqëror.
- 5.3. Shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë te drejtpërdrejtë ose tërthortë në çdo shoqëri që ka objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e Shoqërisë.
- 5.4. Për më tepër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter i cili nuk është i ndaluar nga legjisacioni në fuqi.

#### Neni 6

##### Ndryshimi i Objektit

- 6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë, në respektim të dispozitiveve urdhëruuese të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe parashikimeve të këtij Statuti.

## KAPITULLI III

### Kapitali Themeltar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Ortakët, Largimi dhe Përjashtimi i Ortakëve

#### Neni 7

##### Kapitali Themeltar dhe Kuotat

- 7.1. Kapitali i themeltar i Shoqërisë është në total 1.000 (një mijë) Lekë, i përbërë nga 4 (katër) kuota plotësisht të nënshkruara dhe të shlyera.
- 7.2. Ortakët Themelues zotërojnë kuotat e tyre, që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë si me poshtë:
- Alban Dabulla** zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 60% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 600 (gjashtëqind) Lekë;
  - Shyqyri Dade** zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 15% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Lekë;
  - Adrian Thano** zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 15% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Lekë;
  - Leart Kola** zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 10% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 100 (njëqind) Lekë.
- 7.3. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e çdo Kuote në Kapitalin Themeltar. Çdo Ortak mund t'i kërkojë Shoqërisë, pa shpenzime shtesë, lëshimin e një certifikate që vërteton

zotërimin e kuotës prej tij. Në rastin e Bashkëzotëruesve të një kuote, Shoqëria do të lëshojë një certifikatë në emër të përfaqësuesit duke shënuar cilësinë e tij. Bashkëzotëruesit mund të kërkojnë që emrat e tyre të shënohen në certifikatë. Certifikata nuk përbën letër me vlerë, sipas legjislacionit mbi titujt.

#### Neni 8

##### Zvogëlimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 8.1. Kapitali mund të zmadhohet ose të zvogëlohet në bazë të vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, në përputhje me këtë Statut dhe kërkesat e detyrueshme të Ligjit të Shoqërise Tregtare.
- 8.2. Kapitali do të zmadhohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ashtu si dhe me përfshirjen e rezervave apo fitimeve në kapital.
- 8.3. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet nëpermjet emetimit të kuotave të reja apo duke rritur vlerën e kuotave ekzistuese. Kuotat do të nënshkruhen dhe vlera e tyre do të shlyhet plotësisht.
- 8.4. Shoqëria nuk mund të blejë apo zoterojë asnjë Kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë, nëpermjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, kjo e fundit mund të autorizoje Administratorin të blejë kuotat përkatëse me qëllim annullimin e tyre.
- 8.5. Kontributet e mëtejshme në para, për të cilat Ortakët detyrohen si pasojë e zmadhimit të kapitalit duhet të nënshkruhen dhe të shlyhen plotësisht jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit të vendimit për zmadhimin e kapitalit. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë afate të ndryshme me miratimin e zmadhimit te kapitalit.
- 8.6. Kontributet e mëtejshme në natyrë, si rrjedhojë e zmadhimit të kapitalit, duhet të kalohen tërësisht përparrë regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Vlerësimi i kontributeve në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

#### Neni 9

##### Ortakët

- 9.1. Ortakë të Shoqërisë janë vetëm ata të cilët zoterojnë Kuota të Kapitalit të Registruar të Shoqërisë. Cilësia e Ortakut të Shoqërisë i jepet vetëm personave të cilët kanë fituar kuotat e Shoqërisë apo kanë nënshkruar kuota të reja të krijuara si pasojë e zmadhimit të kapitalit, sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me këtë Statut.
- 9.2. Ortakët e Shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë Kapitalin e Registruar të Shoqërisë.
- 9.3. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borsxhe ose detyrime të tjera, me karakter vetjak, të Ortakëve të saj.
- 9.4. Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 9.5. Ortakë kanë të drejtë që, pas kërkesës së tyre me shkrim drejtar Shqërisë, të marrin brenda afateve të arsyeshme kohore, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë si dhe kopje të çdo dokumentacioni finansiar apo ligjor që i përket Shoqërisë.

#### Neni 10

##### Largimi i Ortakëve

- 10.1. Ortaku i cili kërkon largimin nga Shoqëria, për shkaqe të arsyeshme, në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, duhet të njoftojë Shoqërinë me shkrim duke parashruar të gjitha shkaqet e largimit.
- 10.2. Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit. Në çdo rast Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë ditësh) nga marrja dijeni nga Administratori e njoftimit me shkrim të largimit të Ortakut.

- 10.3. Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendimin nëse Ortakut do t'i likuidohet kuota si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Likudimi i kuotës do të kryhet në përputhje me nenin 14 të Statutit mbi likudimin e kuotave.
- 10.4. Në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin e Ortakut të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhën.

#### Neni 11

##### Përjashtimi i Ortakëve

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme me anë të një vendimi të zakonshëm mund të ngarkojë administratorin t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar pérjashtimin e Ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 102 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 11.2. Përveç sa parashikohet në nenin 102 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në lidhje me të drejtën e kompensimit, Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai pérjashtohet për shkaqe të arsyeshme.
- 11.3. Në datën e vendimit të formës së prerë të gjykatës për pérjashtimin e Ortakut të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhën.
- 11.4. Pasi pérjashtimi i Ortakut është bërë efektiv me anë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, Asambleja e Përgjithshme do të vendos nëse Kuota e ortakut të pérjashtuar do të transferohet ndërmjet ortakëve të tjerë në përpjestim me përqindjet që përfaqësojnë kuotat e zotëruara prej tyre, do të transferohet tek palë të treta të interesuara në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura nga Asambleja e Përgjithshme apo do t'i nënshtrohet regjimit të anullimit në përputhje me nenin 14 të Statutit.

#### KAPITULLI IV

##### Bashkëzotërimi, Transferimi, Anullimi dhe Likuidimi i Kuotave, Vënia në vonesë

#### Neni 12

##### Bashkëzotërimi i Kuotave

- 12.1. Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona nëse miratohet nga Asambleja e Përgjithshme nëpërmjet një vendimi të jashtëzakonshëm. Nëse një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, ata do të konsiderohen nga Shoqëria si një Ortak.
- 12.2. Bashkëzotëruesit e kuotës do të ushtrojnë të drejtat që rrjedhin nga kuota nëpërmjet një përfaqësuesi. Marrëdhënia ndërmjet Bashkëzotëruesve së një kuote, si edhe caktimi i përfaqësuesit të tyre, do të rregullohet nga një marrëveshje e veçantë e lidhur ndërmjet tyre. Një kopje originale e kësaj marrëveshjeje duhet të depozitohet pranë Administratorit të Shoqërisë. Shoqëria do të njohë vetëm marrëveshjet e tila të depozituara pranë Administratorit. Shoqëria mund të refuzojë kryerjen e transaksioneve me personin që pretendon të jetë përfaqësuesi i Bashkëzotëruesve, nëse marrëveshja e bashkëzotërimit nuk është depozituar pranë Administratorit.
- 12.3. Bashkëzotëruesit janë përgjegjës në mënyrë solidare për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës. Veprimet ligjore të Shoqërisë në lidhje me kuotën do të kenë efekt ndaj te gjithë Bashkëzotëruesve edhe nëse veprimi i drejtohet vetëm njërit prej tyre.

#### Neni 13

##### Transferimi i Kuotave

- 13.1. Kuotat janë lirisht të transferueshme midis ortakëve.
- 13.2. Transferimi i Kuotave tek personat e tretë, përmes shitblerjes apo çdo forme tjeter ligjore me kundërshpërbllim, që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, i nënshtrohet këtyre rregullave:
  - a. Ortaku Transferues, duhet t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë vullnetin për transferimin e Kuotës, çmimin e shitjes në rast shitjeje, identitetin e blerësit potencial si dhe të dhëna të tjera që vlerësohen thelbësore në lidhje me transferimin e Kuotës.

- b. Transferimi duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme Ortakëve brenda 1 (një) muaji nga dita e njoftimit. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda afatit 1 (një) muaj, miratimi quhet i dhënë.
  - c. Në rast se Asambleja e Përgjithshme refuzon transferimin, brenda 1 (një) muaji nga data e refuzimit, ortakët duhet të blejnë Kuotën e propozuara për transferim, proporcionalisht me pjesët e zotëruara në kapital, përveç rastit kur bien dakort ndryshe.
  - d. Në rast se asnjë ortak nuk është i interesuar të blejë Kuotën, atëherë Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë nëse:
    - Kuota do t'i shitet një personi të tretë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, sipas çmimit të propozuar nga Ortaku Transferues;
    - Kuota do të blihet nga Shoqeria me qëllim zvogëlimin e kapitalit. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme do të t'ë autorizojë administratorin që të bleje Kuotat nga Ortaku Transferues me qëllim anullimin e tyre dhe zvogëlimin e Kapitalit të Rregjistruar. Çmimi i transferimit do të vendoset nga një ekspert kontabel i pavarur i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme;
- 13.3. Transferimi i Kuotave tek personat e tretë jashtë rradhëve të Ortakëve të Shoqërisë, përmes dhurimit apo formave të tjera të ngjashme i nënshtrohet këtyre rregullave :
- a. Ortaku Transferues, duhet t'i njoftojë Shoqërisë vullnetin për transferimin e Kuotës përmes dhurimit apo formave të tjera të ngjashme, identitetin e përsituesit të dhurimit si dhe të dhëna të tjera që vlerësohen thelbësore në lidhje me këtë lloj transferimi.
  - b. Transferimi përmes dhurimit apo formave të tjera të ngjashme, do t'i nënshtrohet miratimit të Asamblesë së Përgjithshme, e cila jep miratimin brenda 1 (një) muaji nga njoftimi i Ortakut Transferues.
  - c. Në rast se Asambleja refuzon transferimin, brenda 1 (një) muaji nga data e refuzimit, duhet t'ë autorizojë administratorin që të blejë Kuotën nga Ortaku Transferues me qëllim anullimin e tyre dhe zvogëlimin e Kapitalit të Rregjistruar. Çmimi i blerjes do të përcaktohet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme sipas parashikimeve të këtij Statuti.
- 13.4. Transferimi i Kuotave tek trashëgimtari i Ortakut në rast vdekje të këtij të fundit i nënshtrohet këtyre rregullave :
- a. Shoqëria nëpërmjet një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme miraton ose refuzon dhënien e kuotës Trashëgimtarit.
  - b. Në rast se Asambleja e Përgjithshme miraton transferimin e kuotës tek trashëgimtari, trashëgimtari i pranuar nga Shoqëria do të zotërojë te drejtat, detyrimet e përgjegjësítë e Ortakut nga i cili ka fituar kuotën.
  - c. Në rast se Asambleja e Përgjithshme refuzon transferimin e kuotës tek trashëgimtari ajo shpall nisjen e procedurës së likuidimit të kuotës në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Statutit dhe kuota do u ofrohet fillimisht Ortakëve të tjerë në përpjestim me përqindjen që përfaqëson kuota e zotëruar prej tyre në Shoqëri.
  - d. Nëse Ortaket nuk pranojnë nënshkrimin e kuotës Asambleja e Përgjithshme vendos nëse:
    - Kuota do t'i ofrohet palëve të treta të interesuara në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura nga Asambleja e Përgjithshme; ose
    - Kuota do t'i nënshtrohet regjimit të anullimit në përputhje me nenin 13 të Statutit.
- 13.5. Transferimi i Kuotave duhet të kryhet me një akt të shkruar sipas kërkësave të ligjit.
- 13.6. Çdo transferim i kryer në kundërshtim me rregullat e sipërpërmendura është i pavlefshëm, dhe Ortaku Transferues do të jetë përgjegjës kundrejt Ortakeve të tjerë dhe Shoqërisë për démet e shkaktuara.
- 13.7. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave transferohen tek çdo zotëruar i ri i këtyre Kuotave.

#### Neni 14

##### Anullimi dhe Likuidimi i Kuotave

- 14.1. Anullimi dhe likuidimi i kuotave të shoqërisë lejohet vetëm në rastet e vdekjes, largimit, përjashtimit, falimentimit dhe likuidimit të Ortakut.

- 14.2. Në rastin e përjashtimit të Ortakut dhe në përputhje me nenin 10.2 të Statutit, anullimi nuk do të pasohet nga likudimi i Kuotës Ortakut të përjashtur për shkaqe të arsyeshme të parashikuara në nenin 102 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 14.3. Vendimi për anullimin dhe likuidimin e kuotave do të merret nga Asambleja e Përgjithshme e cila do të autorizojet Administratorin(ët) të nisë procedurën për anullimin dhe likuidimin e një ose disa kuotave dhe do të emërojë ekspertin kontabël të autorizuar i cili në bashkëpunim me Administratorin do të përcaktojë vlerën e kuotës për likuidim. Procedura e anullimit dhe likuidimit të kuotës do të kryhet nga Administratori(ët) e Shoqërisë.
- 14.4. Eksperti kontabël do të përcaktojë vlerën e kuotës për likuidimi që do t'i paguhet Ortakut apo Trashëgimtarit të tij, në një shumë jo më të madhe se:
- vlera e Shoqërisë sipas librave kontabël, në raport me përqindjen e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuota e likuiduar; dhe
  - pjesa e dividendifit që do t'i takonte Ortakut, sipas përcaktimit në Çertifikatën e Aftësisë Paguese në përputhje me nenin 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 14.5. Vlerat për tu likuiduar sipas paragrafit (3) do të llogariten në përputhje me pasqyrat financiare IFRS të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për vitin ushtrimor gjatë së cilës është vendosur likuidimi i kuotës. Pagesa e shumave të likuiduara do të kryhet pas miratimit të pasqyrave përkatëse financiare, brenda afateve dhe me këstet e nevojshme për të ruajtur likuiditetin (*cash flow*) e rregullt për Shoqërinë.
- 14.6. Ortaku apo Trashëgimtari mund t'i kërkojë Administratorit të paguajnë shumat e likuidimit, pa vonesë, mbas mbylljes së vitit ushtrimor bazuar në parashikimet e pasqyrave financiare, duke u pranuar ulje te shumës qe përfitohet. Nëse Ortaku apo Trashëgimtari pranon shumat e ofruara nga Administratori sipas këtij paragrafi, ai heqë dorë në mënyrë të parevokueshme nga pretendimi i shumave të mëtejshme në lidhje me kuotën.
- 14.7. Anullimi dhe likuidimi i kuotës mund të kryhet gjithmonë në marrëveshje me Ortakun që e zotëron atë. Kur likuidimi i kuotës kryhet me miratimin e Ortakut që e zotëron atë, shumat që likuidohen dhe kushtet përkatëse do të caktohen në marrëveshje me Ortakun.

## Neni 15

### Venia në Vonesë

- 15.1. Administratori u dërgon ortakëve rjoftimin e vénies në vonesë në rast se këta të fundit nuk kanë shlyer kontributet e tyre në lidhje me kuotat. Administratori me anë të rjoftimit të vénies në vonesë, do të njostojë ortakët për vonesën në lidhje me shlyerjen e kontributeve të kuotave të tyre duke përcaktuar kur dhe ku duhet të kryhet shlyerja.
- 15.2. Mbas marrjes së rjoftimit, çdo ortak do t'i paguajë Shoqërisë, sipas kërkesave të rjoftimit për vénien në vonesë, shumën e pashlyer të kontributit të tij brenda jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
- 15.3. Ortaku ndaj të cilës bëhet kërkesa për shlyerje do të jetë përgjegjës ne mënyrë solidare me personin te cilët i ka kaluar kuotën e pashlyer, pavarësisht nëse kuota është kaluar përpara apo pas kërkesës për shlyerje.
- 15.4. Nëse kontributet e pashlyera nuk paguhën brenda afatit të kërkuar, Ortaku do të paguajë një interes mbi shumën e pashlyer duke filluar nga dita kur kjo shumë duhet të ishte shlyer sipas rjoftimit e deri në pagesën e saj, me normë interes i vjetor prej 4%.
- 15.5. Nëse kontributi mbetet i papaguar pavarësisht vénies në vonesë, Administratori mund ti japë Ortakut që është vénë në vonesë, me anë të një rjoftimi të ri, një afat te mëtejshëm prej jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë duke i kërkuar pagesën e shumës të pashlyer bashkë me interesin që mund të jetë akumuluar. Rjoftimi duhet të përmbyajë kohën dhe vendin ku duhet të kryhet pagesa. Rjoftimi duhet gjithashtu të përcaktojë se në rast mospagese të kontributit të pashlyer Ortaku që zotëron kuotën humbet të drejtë e pjesëmarrjes dhe votës në Asamblenë e Përgjithshme, dhe votat e tij nuk llogariten për arritjen e kuorumi. Gjithashtu, Ortaku që zotëron kuotën humbet të drejtë përfituar dividend dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga kuota e pashlyer.
- 15.6. Nëse kontributi i pashlyer nuk paguhet brenda 30 ditësh nga afati i caktuar në paragrafin 5 te këtij nen, Shoqëria nëpërmjet një vendimi te Administratorit mund:



- a) Të ofrojë kuotën e pashlyer Ortakëve te tjerë, në përpjesëtim me kuotën e zotëruar prej tyre në Shoqëri; ose
- b) Nëse Ortakët e tjerë nuk pranojnë nënshkrimin e kuotës se pashlyer, t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me shumën e pashlyer në.
- 15.7. Parashikimet e këtij nenit do të zbatohen edhe për Bashkëzotëruesit.

## KAPITULLI V Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

### Neni 16

#### Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 16.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë ortakët e saj.
- 16.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.
- 16.3. Çdo ortak ka të drejtë të perfaqësohet në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nga një person tjeter, jo domosdoshmërisht ortak, me anë të një autorizimi me shkrim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite. Autorizimi duhet të permbojë tagrat dhe mënyrën e votimit të përfaqësuesit në Asamblenë e Përgjithshme.

### Neni 17

#### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 17.1. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori ose nga çdonjëri prej Ortakëve që përfaqëson të paktën 5% të numrit total të votave, në perputhje me kërkesat e nenit 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 17.2. Mbledhja e zakonshme e Asamblejsë së Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit Shkurt, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm. Asambleja e Përgjithshme mund të mblidhet në një vendndodhje të ndryshme nga selia e Shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.
- 17.3. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet me letër rekomande me njoftim marrjeje, ose me postë elektronike në adresën elektronike të regjistruar Ortakëve, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 17.4. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përbajë informacion mbi çështjet që do të diskutohen dhe mbi të cilat do të merret vendim (rendi i ditës), vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë, si edhe procedurat e detajuara të pjesëmarrjes dhe të votimit, informacion mbi vendin dhe mënyrën e marrjes së dokumentacionit dhe projekt vendimeve të asamblesë si edhe elementët e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- 17.5. Asambleja e Përgjithshme do të quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë Ortakët që përfaqësojnë 100 % Kapitalin e Shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar me prokurë, dhe shprehen dakort për të zhvillur Mbledhjen e Asamblesë pavarësisht parregullsive në thirrjen e saj.

### Neni 18

#### Punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 18.1. Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Administratori, i cili emëron një sekretar për mbajtjen e procesverbalit të Mbledhjes. Ortakët e pranishëm me të drejtë vote me shumicën prej  $\frac{3}{4}$  të votave, mund të vendosin që mbledhja të kryesojet nga një person tjeter.
- 18.2. Administratori, në cilesinë e Kryetarit të Mbledhje, ka kompetenca të plota për të kontrolluar autorizimet e përfaqësimit të Ortakut në Asamble dhe rregulsinë e tyre dhe për të përcaktuar nëse asambleja është mbledhur rregullisht dhe nëse është arritur kuorumi i domosdoshëm për të marrë

vendime të vlefshme. Kryetari ka gjithashtu të drejtën për të drejtar diskutimet dhe përcaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

- 18.3. Nëse Administratori nuk është i pranishëm apo nuk dëshiron të veprojë si Kryetar i mbledhjes, apo nëse asnjë Administrator nuk është i pranishëm brenda pesëmbëdhjetë minutash nga koha e caktuar për mbajtjen e mbledhjes, Ortakët e pranishëm me të drejtë vote do të caktojnë Kryetarin, si dhe personin që do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.
- 18.4. Ortakët pranojnë dhe bien dakord që të marrin Vendime Qarkulluese me Shkrim, pa qënë nevoja për të qënë fizikisht të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë. Draft-Vendimet e propozuara së bashku me dokumentacionin mbeshitetës do t'u dërgohen Ortakëve me postë të regjistruar, fax, e-mail të regjistruar të Ortakëve, ose mënyra të tjera elektronike të sigurta. Ortakët do të votojnë në lidhje me Draft-Vendimet, brenda një periudhe prej 7 (shtatë) ditësh nga dita që ju është dorëzuar ky Draft dhe do të miratojnë Vendimet Qarkulluese duke kthyer me postë të regjistruar në adresën e Shoqërisë drejtar Administratorit të Shoqërisë, një kopje të nënshkruar. Vendimi Qarkullues me shkrim do të konsiderohet i miratuar nëse aprovohet nga shumica e kerkuar nga Ligji për Shoqeritë Tregtare dhe ky Statut. Administratori regjistron dhe u njofton Ortakëve rezultatet e Vendimit Qarkullues.
- 18.5. Ortaku mund të autorizojë persona të tjera sipas dispozitive të Ligji Tregtar për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Autorizimi bëhet me shkrim dhe është i vlefshëm vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite. Autorizimi duhet të përbajë tagrat dhe mënyrën e votimit dhe duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë jo më vonë se 24 orë përpëra orës së datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Autorizimi i depozituar mbas këtij afati nuk mund të përdoret në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.6. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbale të cilat nënshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe sekretari. Prosesverbalit i bashkëlidhet dokumenti i thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë dhe autorizimet e përfaqësimit të Ortakut në Asamble. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve depozitohen në Regjistrin e Vendimeve të Shoqërisë. Vendimet e paregjistraura janë të pavlefshme.
- 18.7. Nëse Shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, të përcaktuara në këtë Statut dhe në Ligjin për Shoqeritë Tregtare, ushtrohen nga ortaku i vetëm. Vendimet e Ortakut të Vetëm do të regjistrohen në Regjistrin e Shoqërisë në rast të kundërt do të konsiderohen të pavlefshme.


## Neni 19

### Kuorumi dhe Vendim-Marrja

19.1. Në rast vendimesh të zakonëshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm Ortakët zotëruar të më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të Kuotave me të drejtë vote. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund te mblidhet per shak te mungesës se Kuorumi në thirrjen e parë, Asambleja mund të mblidhet përsëri me të njëtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga thirrja e parë. Në rast vendimesh të zakonëshme, këto të fundit merren me votën pro të shumicës së Ortakëve të pranishem apo të përfaqësuar.

19.2. Asambleja e Përgjithshme mund të marre vendime të zakonshme për çështjet e mëposhtëme:

- Vendasjen e politikava tregtare;
- Mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët e Shoqërisë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Përcaktimin e shpërblimit të Administratorëve, eksperëtive kontabël, audituesve dhe likuiduesve;
- Perfaqësimin ne gjykate të Shoqerise dhe ne procedura të tjera kunder Administratoreve;
- Miratimin e transferimit të Kuotave të Shoqërisë tek palët e treta, jashtë rradhëve të ortakëve;
- Likuidimin dhe anullimin e Kuotave;
- Vendime ne lidhje me çështjet e parashikuara në nenin 82 paragrafi 3, 4, 5, 6 të Ligjit për Shoqeritë Tregtare të cilat përfshijnë vendime në rastet kur:



- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndermjetme financiare rezulton ose ekziston treziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
  - Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e të gjithë aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
  - Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% e aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Çështje të tjera që parashikohen nga Ligji ose Statuti, dhe që nuk përfshihen në paragrafin 11.4. më poshtë.
- 19.3. Në rast vendimesh të jashtëzakoneshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm Ortakët zotëruar të më shumë se 50% (pesëdhjetë) përqind të Kuotave me të drejtë vote. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së Kuoromit në thirrjen e parë, Asambleja mund të mblidhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga thirrja e parë. Në rast vendimesh të jashtëzakonëshme, këto të fundit merren me votën pro të  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e Ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.
- 19.4. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të jashtëzakonëshme për çështjet e mëposhtme:
- Ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
  - Zmadhimin ose zgogrimin e Kapitalit, apo realizimin e shpërndarjes ose të emetimit të Kuotave, ose çfarëdolloj garancie tjetër, ose dhënen e çdo opzioni apo të drejtë nënshkrimi ose konvertimin e çdo instrumenti në kuota apo garanci;
  - Shpërndarjen e fitimeve vjetore në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes së Ortakëve;
  - Themelimin, blerjen ose shitjen e Filialeve, Degëve apo Zyrave të Përfaqësimit të Shoqërisë;
  - Riorganizimin e Shoqërisë në një formë tjetër, shpërndarjen, shndërrimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqërisë;
  - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
  - Emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve;
  - Ndërmarrjen e çdo veprimi i cili, rrezikon që të çojë Shoqërinë në likuidim ose falimentim.

## KAPITULLI VI Administratori

### Neni 20

#### Emërimi, Kohëzgjatja e Mandatit dhe Shkarkimi i Administratorit

- 20.1. Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Administratori përfaqëson shoqërinë në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë, e cila nuk përfshihet në kompetencat e Asamblesë së Ortakëve, në perputhje me Statutin dhe Ligjet e Zbatueshme.
- 20.2. Përveç rastit kur Asambleja e Përgjithshme ka parashikuar ndryshe:
- nëse Shoqëria cakton një Administrator, ai do të ketë tagra përfaqësimi të pakufizuara;
  - nëse caktohen më shumë se një Administrator, ata do administrojnë së bashku Shoqërinë dhe kanë kompetencia të njëjtë.
- 20.3. Administrator i Shoqërisë është Z. Adrian Thano, lindur më 13.03.1975, në Fier, Shqipëri, banues në adresën Rr. Medar Shtylla Kom. Dulaku - Kika, Hyrja 2 Ap. 24, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, mbajtës i Leternjoftimit Nr. 028819733, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 20.4. Kohëzgjatja e emërimit të Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetesh, me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati. Asambleja e Përgjithshme mund të vendose rregulla në lidhje me emërimin e Administratorit të cilat do të pasqyrohen në aktin e emërimit.
- 20.5. Administratori mund të shkarkohet, në çdo kohë, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



- 20.6. Administratori i një Shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhen si Administrator i Shoqërisë dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundershtim me këtë dispozitë është absolutisht i pavlefshëm.

#### Neni 21

##### Të Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit

- 21.1. Administratori i Shoqërisë perfaqëson Shoqërinë individualisht.
- 21.2. Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë:
- Të kujdeset për aktivitetin tregtar të përditshëm të Shoqërisë;
  - Të thërrasë dhe drejtojë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme;
  - Të menaxhoje aktivitetin tregtar të Shoqërisë duke zbatuar strategjitet, politikat dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - Të sigurojë zbatimin, nga ana e Shoqërisë, të legjislacionit në fuqi dhe të standardeve të kontabilitetit;
  - Të sigurohet që pasqyrat financiare dhe librat kontabel të mbahen në mënyrën e duhur. Të nënshkruaj bilancet vjetore, llogaritë e konsoliduara dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me rekomandimet për Asamblenë e Përgjithshme për shperndarjen e fitimeve;
  - Të përgatisë çdo njoftim dhe çdo dokument tjetër që mund të kërkohet nga ligji apo Statuti dhe të mbajë Regjistrin e Vendimeve të Shoqërisë;
  - Të krijojë një sistem paralajmerues në lidhje me ngjarjet që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
  - Të depozitojë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe çdo autoritet tjetër shtetëror sipas nevojës;
  - Të raportojë përparrë Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për Shoqërinë, të cilat janë autorizuar paraprakisht prej Asamblesë së Ortakëve;
  - Të zbatojë të gjitha vendimet dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme;
  - Të zbatojë detyrat e ngarkuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Ligji sipas rastit.
  - Të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët dhe të lidhë çdo kontratë/veprim juridik brenda kufizimeve të përfaqësimit të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme;
- 21.3. Administratori mbikqyr dhe siguron që zyrtarët, agentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.

#### Neni 22

##### Shpërblimi dhe Tagrat e Përfaqësimit

- 22.1. Administratori mund të përfitojnë shpërblime ose të ardhura, përfshirë pjesë nga fitimet e Shoqërisë apo të drejtën e blerjes së kuotave. Skema për këto përfitime miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 22.2. Çdo kufizim i tagrave të përfaqësimit të Administratorit do të njoftohet dhe do të registrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 22.3. Në përputhje me nenin 96 (2) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në rastin kur Administratori kanë të drejtën të përfaqësojnë Shoqërinë bashkërisht, ata mund të autorizojnë disa prej tyre për të përbushur transaksione të veçanta ose disa lloje të caktuara transaksionesh. Në këtë rast, të gjithë Administratorët do të janë përgjegjës për veprimet e kryera nga administratori i autorizuar.

#### KAPITULLI VII Administrimi Financiar i Shoqërisë

#### Neni 23

##### Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 23.1. Asambleja e Përgjithshme emëron ekspertë kontabël të autorizuar, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
- 23.2. Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standartet e kontabilitetit.

## Neni 24

### Viti Financiar

24.1. Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit.

## Neni 25

### Mbajtja e Llogarive

25.1. Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

## Neni 26

### Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

- 26.1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit dhe mënyra e saj do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, me Marrëveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.
- 26.2. Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjisacionit shqiptar për fondin rezervë të detyrueshem.
- 26.3. Në baze të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria mund të shpérndajë fitimin tek Ortakët vetëm nëse pas shpërndarjes së divididentit:
- (i) asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit, dhe
  - (ii) Shoqëria ka aktive likuide të mjafueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve të ardhshëm.

## KAPITULLI VIII

### Ndryshimi i Formës Ligjore, Prishja, Likuidimi

## Neni 27

### Ndryshimi i Formës Ligjore

- 27.1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat përkatëse të Legjisacionit Shqiptar dhe këtë Statut.
- 27.2. Shoqëria e re do të përbushë të gjitha procedurat ligjore të themelimit dhe regjistrimit në Shqipëri.

## Neni 28

### Prishja e Shoqërisë

- 28.1. Shoqëria mund të prishet në rrëthanat e mëposhtme:
- (i) Në të gjitha rastet e parashikuara nga neni 99 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
  - (ii) Për arsyet tjera të parashikuara në çdo kohë me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 28.2. Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ninen 43 të Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## Neni 29

### Likuidimi

- 29.1. Në rast prishjeje Shoqëria duhet të likuidohet.
- 29.2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidator, ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët do të hartojnë reportin përfundimtar mbi aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë, dhe mbi procedurat dhe kohën e duhur për likuidimin.
- 29.3. Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 29.4. Pas shlyerjes së kreditoreve dhe mbledhjes së kredive të mbetur, likuiduesit do t'u shpérndajnë Ortakëve aktivet e mbetur në përpjestim me kuotat që ata zotërojnë.

## KAPITULLI IX

### Të ndryshme

**Neni 30**  
**Njoftimet**

- 30.1. Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statutit, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre dhe të regjistruar pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 30.2. Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat, ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statutit, do të konsiderohen të kryera rregullisht në adresat e Ortakëve dhe të marra prej këtyre të fundit kur njoftimi, kërkesa apo komunikimi është: (i) dorëzuar personalisht nga Administratori (ii) dërguar me postë rekomande me kthim përgjigje ose i është (iii) dërguar pranë adresës së regjistruar të postës elektronike të regjistruar të Ortakëve.

**Neni 31**


**Ligji i Zbatueshëm dhe Gjykata Kompetente**

- 31.1. Çdo çështje tjeter, e cila nuk është parashikuar në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 31.2. Ortakët bien dakort që çdo ose të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Statutit do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre dhe në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 31.3. Ky Statut është hartuar në 4 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.


\*\*\*\*\*

**ORTAKËT THEMELUES**

Alban Dabulla



Shyqyri Dade

  
Adrian Thano

Leart Kola

